




REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



MODELE PYETJESH NGA MËSUESIT PËR MËSUESIT

ARSIMI I MESËM I ULËT DHE ARSIMI I MESËM I LARTË

LËNDA:

HISTORI

TETOR
2021

Materiali “Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit ”, lënda “Histori”, u hartua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me mësues të lëndës së historisë në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.

Koordinoi punën për hartimin e materialit

Ines Todhe, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi, ASCAP

Dr. Dorina Rapti, ASCAP

Koordinoi redaktimin letrar

Erida Koleci, ASCAP

Rozeta Hyseni, ASCAP

Koordinoi faqosjen

Esion Zgjana

Prodhim i ASCAP-it, 2021

www.ascap.edu.al

© Copyright 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	3
HYRJE	4
KLASA VI.....	10
KLASA VII.....	15
KLASA VIII	21
KLASA IX.....	27
KLASA X	34
KLASA XI.....	41

HYRJE

Detyra e historisë është të drejtojë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës.

Mësimi i historisë është kritik dhe i domosdoshëm:

- Për të maksimizuar potencialin e një shoqërie demokratike. "Njohja e historisë është parakushti i inteligjencës politike dhe krijimit të një qytetari të informuar që merr pjesë aktive në proceset demokratike të shoqërisë.
- Për të kuptuar diversitetin e botës së sotme. " Veçanërisht e rëndësishme është respektimi i kulturave të ndryshme, në shoqërinë tonë gjithnjë e më pluraliste dhe në një botë gjithnjë e më të ndërvarur."
- Për të edukuar individin. Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga "mësimet" historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën, na bën "të burgosurit" e saj.

Një nga qëllimet kryesore të lëndës së historisë është të zhvillojë konceptet kyç, kompetencat dhe aftësitë historike, si: *kërkimi historik, përdorimi i burimeve, analiza shkak-pasojë, interpretimi historik, shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën*. Programet e historisë në arsimin parauniversitar theksojnë zhvillimin e këtyre kompetencave dhe vlerësimin e aftësive që ato zhvillojnë.

Sa herë mësuesi i historisë është duke vlerësuar nxënësit mbi arritjen e njohurive dhe aftësive të lëndës, ai njëkohësisht është duke ju përgjigjur pyetjeve të tilla si:

- Çfarë do që nxënësit të njohin apo të jetë në gjendje të bëjnë? (rezultatet e të nxënit)
- Cila është metoda/teknika më e mirë e vlerësimit për t'u përdorur për përmbushjen e rezultateve të të nxënit? (lloji i vlerësimit)
- Si do t'i vlerësojë përgjigjet e nxënësve? (analiza e rezultateve)

- Çfarë do të bëjë me informacionin e mbledhur? (reflektimi, ndërhyrja për përmirësim)

Pyetjet janë një nga teknikat kryesore të vlerësimit në lëndën e historisë. Ato janë mjete në sajë të së cilit mësuesit arrijnë të kuptojnë se çfarë njohurish dhe aftësish zotërojnë nxënësit, cilat janë pikat e dobëta të tyre dhe në cilat aspekte duhet të përkushtohen, në përputhje me rezultatet e të nxënësve. Të pyeturit shërben jo aq për ta kontrolluar se sa për ta ndihmuar nxënësin që t'i afrohet përgjigjes së pritshme. Mësuesi pyet:

- Për të kontrolluar dhe vlerësuar njohuritë, aftësitë dhe shprehjet e nxënësve (*kompetencat e lëndës*)
- Për të nxitur kujtesën e nxënësve
- Për të nxitur mendimet kritik
- Për të zhvilluar imagjinatën e tyre
- Për të nxitur nxënësit të argumentojnë
- Për të inkurajuar zgjidhjen e problemeve

Megjithëse të pyeturit është një ndër teknikat e përdorura më së shumti në mësimdhënie, ka raste jo të pakta kur të pyeturit fokusohet kryesisht në riprodhimin e informacionit specifik, dhe më pak në të nxënësve. Pyetjet të cilat i ftojnë nxënësit të reflektojnë, të mendojnë, të rindërtojnë, të përfytyrojnë, të vlerësojnë, të krijojnë mbështesin dhe nxisin zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe krijes të nxënësve.

“Pyetjet e mira” konsiderohen ato lloj pyetjesh të cilat:

- janë të qëllimshme (kërkohej të arrihet një qëllim specifik)
- janë të qarta (nxënësit kuptojnë çfarë u kërkohej)
- janë përgjithësisht jo të gjata në formulim (me sa më pak fjalë të jetë e mundur)
- janë të përshtatura me nivelin e klasës
- nxisin të menduarin (“Si?”, “Në ç’ rrethana...?”, “Pse?”)
- janë të balancuar (*pyetje riprodhuese dhe pyetje që nxisin të menduarin kritik e krijes*)

Në tabelën më poshtë prezantohen tipa model pyetjesh për secilën kompetencë të cilat mësuesit e lëndës së historisë mund t'i përdorin dhe t'i zhvillojnë më tej për vlerësimin e kompetencave dhe koncepteve kyç historike. Janë përzgjedhur kryesisht modele pyetjesh të cilat nxisin aftësitë e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore të tilla si:

- Ç' skenë ju del përpara kur...?"
- Po sikur të vepronim ... ç'do të kishte ndodhur?
- Si duhet të kishim vepruar ndryshe?
- Ç' drejtim do të kishte marrë situata nëse ...?
- A kishte ose ka mënyrë tjetër për të zgjidhur çështjen?
- Cili do të ishte rezultati/ përfundimi?
- A ka përfundim tjetër?

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të tilla nxënësit duhet të përdorin të gjitha njohuritë e marra dhe përvojën e tyre. Njëpërmjet këtyre pyetjeve ata krijojnë analogji midis ngjarjeve, çështjeve, proceseve apo figurave historike, ndërtojnë kompetencat dhe konceptet kyç historike duke krijuar kontekste të reja.

Tabela 1: Modele pyetjesh për zhvillimin e kompetencave historike

Kompetenca	Pyetje të mundshme për zhvillimin e kompetencave	Modele pyetjesh
<p>Kërkimi historik</p> <p>Njohja e fakteve, ideve, koncepteve historike dhe organizimi kronologjik. Aftësia për të shtruar pyetje historike, aftësia për të kuptuar kohën në lidhje me historinë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë mund të mbani mend rreth_____? - Çfarë çoi në_____? - Vendosini këto ngjarje në rendin e duhur. - Listo_____. - Çfarë pyetjesh të reja keni pasi e keni mësuar këtë (duke lexuar këtë, duke parë këtë)? - Për çfarë doni të dini më shumë_____? - Si do ta gjeni përgjigjet për këto pyetje? - Çfarë përfundimi keni arritur nga hulumtimi juaj? Pse? 	<ul style="list-style-type: none"> - Vendosini ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore në rendin e duhur kronologjik. - Shkruani përgjigjen për pyetjen: "Sa e suksesshme ishte lëvizja për të Drejtat Civile në Amerikë?" <p><i>(Nxënësit do të argumentojnë përgjigjet e tyre duke përdorur informacione specifike nga</i></p>

		<i>periudha kohore deri në ditët e sotme.)</i>
<p>Përdorimi i burimeve Vlerësimi i dokumenteve historike (konteksti kur është shkruar dokumenti dhe perspektivat e individëve që e shkruar dokumentin). Aftësia për të vlerësuar burimet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Si e dini? - Përmbledhni atë që lexoni.... - Çfarë thotë ky historian për këtë ngjarje? - Kush është autori? Vlerësoni besueshmërinë e tij ose të saj. <p>Si ka ndikuar konteksti/situata historike që autori ta thoshte këtë?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kujt burimeve i jeni referuar për t'ju përgjigjur pyetjes: "Si do të ishte jeta sot nëse Lufta e Dytë Botërore nuk do të kishte ndodhur kurrë?"
<p>Analiza shkak-pasojë Arsyetimi historik dhe interpretimi i ngjarjeve mbështetur në burime. Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Çfarë do të kishte ndodhur nëse - Si është kjo (përvoja historike) referuar një përvoje tjetër (përvoja historike)? - Çfarë menduan njerëzit (në atë periudhë kohore)? - Pse ndodhi kjo (ngjarje e diskutueshme)? Çfarë do të kishit bërë po të kishit qenë atje? 	<ul style="list-style-type: none"> - Hulumtoni dhe mblidhni informacion për t'iu përgjigjur pyetjes: "Si do të ishte jeta sot nëse Lufta e Dytë Botërore nuk do të kishte ndodhur kurrë?"
<p>Interpretimi historik Aftësia për të analizuar, sintetizuar, interpretuar dhe vlerësuar burimet historike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruani_____. - Cila pjesë e këtij rrëfimi është fakt dhe cila është interpretim? 	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruani si kanë qenë marrëdhëniet me perëndim në periudhën e mbretit Zog dhe në periudhën e komunizmit.

	<ul style="list-style-type: none"> - Cili interpretimi (i kësaj ngjarje historike) është më i saktë, më i besueshëm? Pse? 	<ul style="list-style-type: none"> - Krahasoni si kanë qenë marrëdhëniet me perëndim në periudhën e mbretit Zog dhe në periudhën e komunizmit? - Interpretoni si ndryshuan këto marrëdhënie? - Në cilat fakte e mbështesni interpretimin tuaj?
<p>Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën</p> <p>Argumentimi dhe vlerësimi i ngjarjeve dhe proceseve në të shkuarën dhe në të tashmen, për të marrë vendime të informuara rreth tyre. Aftësia për të vlerësuar ngjarjet figurat dhe proceset historike në kontekstin e tyre dhe në ditët e sotme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Argumentoni zgjedhjet e ndryshme që njerëzit bëjnë sot dhe mënyrat se si ata reagojnë (situatë e veçantë). - Pse ekziston kjo situatë sot? Çfarë do të rekomandonit ju? Pse? - Pse e the këtë? 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësoni "Si do të ishte jeta sot nëse Lufta e Dytë Botërore nuk do të kishte ndodhur kurrë?"

Pyetjet i shërbejnë jo vetëm vlerësimit për të nxënë, por ato janë shumë të rëndësishme dhe në kontekstin e vlerësimit të të nxënësve. Pyetjet janë pjesë e testeve dhe matinit arritjet e nxënësve.

Testet ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me vlerësimin e arritjes së rezultateve të të nxënit. Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish dhe aftësish mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- Vlefshmërinë e pyetjeve, d.m.th., garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë. *(Ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehi(kompetenca) që përmbushin rezultatet e të nxënit që mësuesi ka për qëllim të kontrollojë).*
- Pyetjet në test është mirë të radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre, nga më e thjeshta te ajo më komplekse.
- Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës për një periudhë, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.
- Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- Testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme (e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër, pyetje të tipit ese etj.)

Më poshtë jepen shembuj me pyetje të llojeve të ndryshme, për secilën klasë, në arsimin të mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë në lëndën e historisë. Këto modele synojnë të ofrojnë për mësuesit shembuj pyetjesh të cilat ata mund t'i përdorin kur hartojnë teste. Modelet e prezantuara më poshtë **nuk janë shteruese**. Mësuesit mund të hulumtojnë dhe të krijojnë vetë pyetje të tjera që zhvillojnë kompetencat dhe konceptet kyç historike, motivojnë e nxisin të nxënit e nxënësve dhe matin në çfarë shkalle janë përmbushur rezultatet e të nxënit të parashikuara për t'u matur.

KLASA VI

Pyetja 1:

Në krye të Perandorive qëndronin perandorët të cilët bënin luftëra, shpallnin paqen, miratonin ligje, krijonin institucione etj. Ata vendosnin për gjithçka në perandori dhe mendonin se ky pushtet ju buronte nga zoti. Perandori në Perandorinë Bizantine konsiderohej:

- A) Funkionar i lartë i shtetit
- B) Nënpunës i lartë ushtarak
- C) Kreu i Kishës Ortodokse
- D) Kreu i pushtetit shtetëror dhe fetar

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Prindërit e tuaj dhe ju blini produkte/mallra që janë të prodhuara në vende të ndryshme të botës. Këto produkte/mallra vijnë në Shqipëri nga tregtarët dhe shiten në tregjet dhe dyqanet tonë. Ndërkohë edhe produkte/mallra të prodhuara në vendin tonë shiten në vende të tjera të botës. Tregtia ndërkombëtare nuk ka filluar në kohën që ne jetojmë. Ajo i ka fillesat në shekujt:

- A) XI-XII
- B) XIII-XIV
- C) XV-XVI
- D) XVII-XVIII

Kompetenca dhe konceptet: Interpretimi historik dhe organizim kronologjik.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Në lëndën e historisë keni mësuar se perandoritë krijohen, arrijnë kulmin e më pas shpërbëhen. Një nga perandoritë e fuqishme ishte Perandoria Bizantine e cila arriti lulëzimin e saj në kohën kur në krye të saj ishte perandori Justinian. Përshkruaj ndryshimet që sollën reformat e tij në Perandorinë Bizantine.


Kompetenca dhe konceptet: Interpretimi historik, Ndryshimi dhe vazhdimësia

Lloji i pyetjes: Pyetje e hapur

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Në qytetet dhe fshatrat e çdo vendi të botës jetojnë njerëz të cilët bëjnë punë të ndryshme, dhe marrin të ardhura nga ato i që i sigurojnë vetëm ushqimin e deri tek ata që bëhen të pasur. Sipas të ardhurave ata bëjnë pjesë në shtresa të ndryshme. Edhe në Mesjetë njerëzit jetonin në qytete por edhe në fshatra dhe popullsia ishte e ndarë në shtresa. Plotëso skemën duke përcaktuar elementët që përbëjnë strukturën shoqërore në Europën Mesjetare.



Kompetenca: Kërkimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim

Pikëzimi: 5 pikë

Pyetja 5:

Sistemi feudal dallonte nga ai skllavopronar. Përveç fesë së krishterë në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit VII në gadishullin Arabik lindi një fe e re. Shpjegoni kuptimin e koncepteve/termave të mëposhtëm:

- a) Punë angari: _____
- b) Vasal: _____
- c) Islamizë: _____

Kompetenca: Interpretimi historik.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 6:

Ngjarjet e mëposhtme renditi sipas kohës kur kanë ndodhur.

Krijohet Principata e Arbrit; Lulëzoi Kultura arabe; Lindi Sistemi Feudal.

- a) _____
- b) _____
- c) _____

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik.

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e strukturuar)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 7:

Gjatë periudhës së Mesjetës në Europë lindën, shtete e perandori. Në periudhën e lulëzimit të tyre pësoi zhvillim ekonomia, arti, kultura e shkencat. Por me lindjen e islamizmit filluan konfliktet fetare. Në fjalitë e mëposhtme vendosni “V” për pohimet e vërteta dhe “G” për pohimet e gabuara.

Pohimi	E vërtetë	E gabuar
Manastiret ishin qendra arsimore e kulturore.		
Justiniani forcoi shtetin duke miratuar ligje që rregullonin jetën politike, shoqërore, ekonomike.		
Kryqëzatat ishin ekspedita ushtarake të organizuara nga mbreti		
Perandoria bizantine nuk e ruajti trashëgiminë greko-romake.		

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të shkurtra

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 8:

Në thelb të marrëdhënieve shoqërore gjatë periudhës së mesjetës ishin marrëdhëniet feudale. Përcakto dy tiparet themelore të sistemit feudal.

a) _____

b) _____

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuara

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 9:

Qytetërimi arab lindi dhe u zhvillua në Gadishullin Arabik. Në krye të shtetit arab qëndronte Kalifi. Nën sundimin e kalifëve bota arabe njohu një periudhë të madhe lulëzimi. Shkruaj dy nga arritjet e qytetërimit arab.

a) _____

b) _____

Kompetenca: Analiza shkak-pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 10:

Lexo paragrafin e mëposhtëm dhe harto dy pyetje.

“Qytetet ndikuan edhe në jetën e fshatit. Shkëmbimi mall me mall filloi t’ia lërë vendin shkëmbimit me monedha. Lindi paraja. Feudali filloi t’ia kërkonte bujkrobit një pjesë të detyrimeve në të holla.”

Pyetja 1. _____

Pyetja 2. _____

Kompetenca: Kërkimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 2 pikë

KLASA VII

Pyetja 1:

Nga 25 milionë banorë që kishte Franca, 23 milionë jetonin në fshat. Fshatarët ishin njerëzit më të shtypur dhe më të varfër. Ata paguanin taksa e detyrime ndaj shtetit, kishës dhe fisnikëve. Më 11 gusht 1789 Asambleja Kushtetuese në Francë shpalli me ligj:

- A) Vendosjen e feudalizmit
- B) Vendosjen e kapitalizmit
- C) Heqjen e feudalizmit
- D) Heqjen e kapitalizmit

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Në vitin 1850 SHBA ishte një nga shtetet më të mëdha të botës. Mes pjesës veriore dhe jugore të saj kishte ndryshime të mëdha. Në Veri ishte zhvilluar industria, komunikacioni e tregtia ndërsa në Jug ishte e zhvilluar bujqësia dhe skllavëria zezake. Mosmarrëveshjet mes tyre çuan në shpërthimin e Luftës Civile që u zhvilluan në vitet:

- A) 1861-1865
- B) 1862-1866
- C) 1863-1867
- D) 1864-1868

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Në fillim të shekullit të XX shqiptarët ndodheshin nën sundimin Osman. Ata ndihmuan Turqit e Rinj të vinin në pushtet ngaqë ata kishin premtuar se do ti plotësonin interesat e tyre kombëtare. Në “Librin e kuq” u shkrua kërkesa për:

- A) Krijimin e shtetit të pavarur shqiptar
- B) Krijimin e shtetit autonom shqiptar
- C) Krijimin e qeverisë së shtetit shqiptar
- D) Krijimin e ushtrisë së shtetit shqiptar

Kompetenca: Analiza shkak-pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 4:

Në shekujt XIV-XV në pjesën më të madhe të shteteve të Europës forma e qeverisjes ishte monarki absolute. Në shekujt XVI-XVII disa prej tyre fillojnë të marrin formën e monarkive parlamentare. Plotëso fjalitë duke vendosur termat/konceptet e mëposhtme:

Monarki absolute; Angli; parlament; Francë; mbret; monarki parlamentare;

Format e qeverisjes në _____ ishte monarki absolute ku sundon monarku, ndërsa në _____ forma e qeverisjes ishte _____ ku sundon monarku dhe pushteti i tij kufizohet nga _____.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 5:

Zhvillimi i tregtisë dhe industrisë solli ndryshime në shoqëritë europiane. Në këtë periudhë u zhvillua arti dhe lindën koncepte të reja për jetën, shtetin dhe të drejtat. Përcakto se cilës nga lëvizjet i përkasin tiparet e mëposhtme duke vendosur shenjën “+”:

TIPARET	LËVIZJET		
	<i>Nacionalizmi</i>	<i>Romantizmi</i>	<i>Iluminizmi</i>
Mbronin të drejtën që çdo komb duhet të jetë i lirë.			
Mbrojnë të drejtën për vetëvendosje.			
Mbronin mendimin e lirë dhe barazinë mes njerëzve.			
Çmonin dhe nderonin shumë fenë, traditën dhe luftën për lirinë.			

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinime (me çiftëzim)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Gjatë shekujve XVI-XX popujt e Ballkanit ngrinin krye kundër sundimit osman dhe në sajë të kryengritjeve apo revolucioneve ata arritën të fitojnë autonominë e më pas pavarësinë. Përcakto katër dallimet mes koncepteve “Shtet autonom” dhe “Shtet i pavarur”.


Kompetenca: Analiza shkak pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e strukturuar)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 7:

1. Revolucioni industrial solli zëvendësimin e punës së dorës me makineri. Ky proces filloi afërsisht në vitin 1750 dhe përfundoi në vitin 1850. Revolucioni industrial filloi në Angli. Plotëso skemën duke vendosur një vlerë për çdo degë të ekonomisë.



Kompetenca: Kërkimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim


Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 8:

Shteti serb dhe ai grek nuk e kanë njohur ende shtetin e pavarur të Kosovës. Pretendimet e këtyre shteteve i kanë fillesat që pas krijimit të tyre si shtete të pavarura, periudhë në të cilën territoret shqiptare vazhdonin të ishin nën sundimin Osman. Për realizimin e interesave të tyre ata hartuan programet/ projektet "Naçertania" dhe "Greqia e Madhe". Plotësoni skemën duke vendosur tiparin e përbashkët të programeve/ projekteve:

Naçertania

Greqia e Madhe



Tipari i përbashkët i dy programeve

Kompetenca: Përdorimi i burimeve, Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 9:

Në vitin 1799, Napoleon Bonaparti shpallet Konsull i Parë i Francës. Ai ndërmori reformat ë rëndësishme. Në vitin 1804 ai u shpall Perandor i Francës.

Përshkruaj figurën e Napoleon Bonapartit duke theksuar dy nga sukseset dhe dy nga dështimet e tij.

Sukseset:

1. _____

2. _____

Dështimet:

1. _____

2. _____

Kompetenca: Analiza shkak-pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 10:

Epoka e restaurimit përfshin vitet 1814-1830. Gjatë kësaj periudhe u rimëkëmb Europa, si para Revolucionit Francez. Shih hartën dhe përcakto dy nga ndryshimet që solli Kongresi i Vjenës në Hartën e Europës.



- a) _____
—
- b) _____
—

Kompetenca: Përdorimi i burimeve, Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 2 pikë

KLASA VIII

Pyetja 1:

1. Pas përfundimit të Luftës Civile, jeta politike në Greqi ishte e paqëndrueshme. Në vitin 1967 u vendos regjimi i kolonelëve me:

- A) Revolucion
- B) Grusht shteti
- C) Zgjedhje
- D) Ndërhyrje nga jashtë

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Anëtarësimi i Shqipërisë në OKB hasi vështirësi. Shteti grek kundërshtonte anëtarësimin e Shqipërisë duke përdorur pretendimin e saj për ekzistencën e të ashtëquajturës “gjendje e luftës”. Gjithashtu anëtarësimi pengohej edhe nga Anglia dhe SHBA. Shqipëria bëhet anëtare e OKB-së në:

- A) 14 dhjetor 1945
- B) 14 dhjetor 1955
- C) 14 dhjetor 1965
- D) 14 dhjetor 1975

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Lufta e Ftohtë u mbajt gjallë nga rivaliteti i dy blloqeve ushtarake dhe nga ndarja e Europës në Perëndim e Lindje. Konfliktet ndërmjet tyre shpesh acaroheshin, por asnjëherë nuk u shndërruan në konflikt të armatosur gjithëpërfshirës. Evidento dy nga ballafaqimet mes SHBA dhe BS në planin ushtarak.

a) _____

b) _____

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 4:

Shoqëria sovjetike u zhgënjye nga sistemi socialist dhe ideologjia marksiste dhe kërkonte ndryshimin e sistemit. Shpjego dallimet mes reformës “Perestrojka” dhe “Glasnosti”.

Perestrojka _____

Gllasnosti _____

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje objektive

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 5:

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore solli ndryshime në hartën politike të botës. Vështroni hartën dhe shënoni 4 nga shtetet e Europës që pas Luftës së Dytë Botërore u vendosën regjimet komuniste.



1) _____ 2) _____

3) _____ 4) _____

Kompetenca: Përdorimi i burimeve, Interpretimi historik.

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Pas vitit 1945 në vendet e Ballkanit u përmbysën monarkitë dhe u zbatua modeli sovjetik në politikë dhe ekonomi. Lidh ngjarjet me kronologjinë e tyre.

Koha	Ngjarjet
A) Në vitin 1947	1. Në Varshavë dhe qytete të tjera të Polonisë, filluan demonstratat e mitingjet masive
B) Në vitin 1956	2. Në Bullgari komunistët ndaluan me ligj veprimtarinë e partive të tjera.
C) Në vitin 1949	3. Krijohet një aleance që u quajt Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke (KNER).
D) Në vitin 1968	4. Ushtria sovjetike pushtoi Çekosllovakinë
	5. Studentët çek u ngritën për liri dhe demokraci

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinim (me çiftëzim)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 7:

SHBA dhe Bashkimi Sovjetik ishin dy nga fitueset e Luftës së Dytë Botërore. Në vitet 1945-1990, sistemet që zbatuan në vendet e tyre ishin të ndryshme. Shëno me “+” veçoritë që i përkasin secilit nga shtetet.

Veçoritë	Dy sisteme	
	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	Bashkimi Sovjetik
Shtet totalitarist		
Shtet pluralist		
Ekonomi e lirë e tregut		
Ekonomi e centralizuar		
Ekonomi e planifikuar		

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinime (me çiftëzim)

Pikëzimi: 5 pikë

Pyetja 8:

Lexo fjalitë e mëposhtme dhe interpretoi ato.

“Njeriu nuk është i varur nga asnjë vullnet apo forcë hyjnore apo tokësore që qëndron jashtë tij”. Njeriu e ndërton vetë personalitetin e tij. Ai bën vetë zgjedhjet që dëshiron dhe formon vetveten.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e hapur)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 9:

Nisur nga fundi i shek. XX dhe fillim të shek. XXI, informacioni për ngjarjet që ndodhin në vende të ndryshme të botës shpërndahet shumë shpejt, nëpërmjet internetit. Shtetet apo organizatat bëjnë politika që përfshijnë edhe shtete të tjera. Me gjithë progresin bota sot vuan problemet e ndotjes së mjedisit për shkak të përdorimit të makinave, hedhjes së mbeturinave të industrisë kimike në vende të gabuara etj. Pra, bota e sotme përballet çdo

ditë e më shumë me përhapjen e shpejt të politikave, fenomeneve, ngjarjeve por edhe ndotjen e mjedisit. Evidento një nga pasojat e globalizmit dhe një nga pasojat e efektit “serrë”.

Pasojë e globalizmit

Pasojë e efektit “serrë”

Kompetenca: Kërkimi historik, Analiza shkak pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar.

Pikëzimi: 2 pikë

KLASA IX

Pyetja 1:

Në Ilirinë e Jugut u formua shteti i parë ilir. Evidento kohën kur lindi ky shtet:

- A) Shekulli III pr.k
- B) Shekulli IV pr.k
- C) Shekulli V pr.k
- D) Shekulli VI pr.k

Kompetenca dhe konceptet kyç: Kërkimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Emri *alban*, me të cilin u identifikuan arbrit mesjetarë, i ka fillesat e përdorimit të tij në:

- A) Parahistori
- B) Antikitet
- C) Mesjetë
- D) Rilindje

Kompetenca dhe konceptet kyç: Kërkimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Illirët shtriheshin në Ballkanin Perëndimor. Për origjinën e ilireve janë formuluar dy teza. Shkruaj tezën që mbështet duke përdorur të dhënat nga zbulimet arkeologjike dhe studimet gjuhësore.

Kompetenca: Kërkimi historik, Përdorimi i burimeve, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e hapur)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 4:

Zbulimet arkeologjike tregojnë se gjurmët e para të njeriut në territoret shqiptare i përkasin një periudhe të lashtë, 100 mijë vjet më parë. Shiko hartën dhe shëno 3 nga qendrat parahistorike.



Kompetenca dhe konceptet kyç: Përdorimi i burimeve, ndryshimi dhe vazhdimësia

Lloji i pyetjes: Pyetje objektive

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 5:

Sundimi romak solli ndryshime edhe në jetën shoqërore të Ilirisë. Bëj lidhjen e shtresave dhe veçorive të tyre.

Shtresat	Veçoritë
A) Fshatarët e lirë	1. Aleatë të Romës
B) Administrata romake	2. Zotëronte prona të vogla, të kufizuara
C) Latifondistët	3. Shtresë e pasur që jetonte në qytet
D) Pronarë minierash	4. Gëzonte privilegje të mëdha nga Roma
E) Bujkrobërit	

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinime (me çiftëzim)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Në shek. IX Perandoria Bizantine bëri një ndarje të re administrative ushtarake, sipas sistemit të temave. Shih hartën dhe përcakto shtrirjen e temës së Selanikut.



- A) Tivari në veri, gjiri i Vlorës në jug dhe rrjedha e Drinit në lindje
- B) Epiri i Vjetër deri te gjiri i Korintit
- C) Territoret e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore.
- D) Territoret e Maqedonisë Jugore dhe Greqisë Veriore.

Kompetenca: Përdorimi i burimeve, Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 7:

Lexo paragrafin e mëposhtëm dhe jep gjykim tënd për organizimin e principatave shqiptare.

“... Unë Gjergj Balsha, vëllai im Balsha dhe nipi im, Gjergji i ri, dhe cilido prej fisit tim, erdha në Dubrovnik dhe ripohova miqësinë e vjetër që kanë patur të parët e mi me të parët tuaj dhe u betova të ruaj, të mbroj dhe të ndihmoj qytetin tuaj të Dubrovnikut dhe qytetarët tuaj dubrovnikas kudo ku sundoj dhe kudo ku mund ta shtrij sundimin tim. ...”
Balshajt betohen se do të ruajnë paqen, miqësinë dhe marrëveshjet e vjetra me dubrovnikasit, 17 janar 1368. Në fund të këtij dokumenti është vula me stemën e Principatës së Balshajve

Kompetenca: Përdorimi i burimeve, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e hapur)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 8:

Në fillim të marsit 1444, Skënderbeu thirri një kuvend të fisnikëve arbër dhe princërve fqinjë.

Plotëso fjalitë e mëposhtme:

Lidhja e Lezhës synonte krijimin _____ të fisnikëve shqiptarë dhe fqinjëve të tyre për t'i ballë pushtimit osman. Skënderbeu u zgjodh

_____ U krijua një _____.

Kompetenca: Analiza shkak-pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 9:

Qëndresa e popujve të Ballkanit ndaj sundimit Osman ishte e vështirë. Argumentoni tezën “Skënderbeu mbeti figura më e rëndësishme e shpresës për dëbimin e osmanëve nga Ballkani”

Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive (e hapur)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 10:

Në territoret e pushtuara osmanët emëronin autoritetet lokale, kryenin regjistrimin e të gjitha burimeve ekonomike dhe njerëzore. Përcakto lidhjen mes koncepteve/termave të mëposhtme dhe veçorive të tyre.

Termet/Konceptet	Veçoritë
A) Sanxhak	1) i dërguari i sulltanit
B) Çiflig	2) ngastër toke, njësia më e vogël taksapaguese
C) Timar	3) taksë me origjinë islame
D) Xhize	4) përbëhej nga disa çifligje
E) Emin	5) njësi administrative-territoriale
F) Dizdar	

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinime (**me çiftëzim**)

Pikëzimi: 5 pikë

KLASA X

Pyetja 1:

Përdorni informacionin e mëposhtëm për t'iu përgjigjur pyetjes.

“Miqte e mi të mirë, për herë të dytë në historinë tonë, një kryeministër britanik është kthyer nga Gjermania duke sjellë paqe me nder. Unë besoj se kjo është paqja e kohës sonë.... Shkoni në shtëpi dhe flini të qetë.”

Neville Chamberlain, (Deklaratë pas kthimit të tij nga Konferenca e Mynihut.)

Bazuar në deklaratën e mësipërme, cila prej politikave të mëposhtme do të parandalonte një luftë të re?

- A) Politika e izolimit.
- B) Politika e lëshimeve.
- C) Politika e kundërpërgjigjes.
- D) Politika e dëmshpërblimeve.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse ai është i gabuar.

- a) Lëvizja protestante njihet ndryshe me emrin Reformacion. V/G_____
- b) Lufta civile në SHBA u udhëhoq nga Abraham Linkoln. V/G_____

Kompetenca: Interpretimi historik.

Lloji i pyetjes: Pyetje e vërtetë e gabuar

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 3:

Nga nënshkrimi i Traktatit të Verdunit (viti 843) lindën shtetet e _____
_____.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të shkurtër (me plotësim)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Perandoresha më e njohur e Rusisë ishte Katerina II ose siç njihet në histori Katerina e Madhe. Qëndrimi që ajo mbajti ndaj fisnikërisë ishte i ndryshëm me atë të Pjetrit të Madh. Identifikoni respektivisht dy nga masat e marra nga këta monarkë reformatorë ndaj shtresës së fisnikërisë.

- a) Dy masat që mori Katerina e Madhe:
- b) Dy masat që mori Pjetri i Madh:

Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar (e strukturuar)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 5:

Në kolonën e majtë jepen tiparet e ekonomisë, ndërsa në kolonën e djathtë shtetet ku janë aplikuar. Lidhni me shigjetë sistemin ekonomik me shtetin përkatës.

Shteti luan rolin kryesor në drejtimin e ekonomisë, por u ruajt pronat private	Rusi
U kolektivizua bujqësia dhe u shtetëzua industria	Gjermani
Krijimi i kushteve për funksionimin e tregut të lirë	SHBA


Kompetenca: Analiza shkak-pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinim (me çiftëzim)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 6:

Shekulli XX u karakterizua nga tragjeditë e shkaktuara nga regjimet diktatoriale, të cilat sidomos në Evropë, patën pasoja shumë të rënda njerëzore dhe materiale si dhe një ndikim afatgjatë. Krahasoni totalitarizmin në Rusi me atë në Gjermani dhe plotësoni Diagramin e Venit duke dhënë dy tipare dalluese të totalitarizmit në secilin shtet dhe një veçori të përbashkët midis tyre.



Tiparet dalluese	Veçoria e përbashkët	Tiparet dalluese
1.	1.	1.
2.	2.	2.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar

Pikëzimi: 5 pikë

Pyetja 7:

“Unë i gjuajta Franc Ferdinandit dy herë nga një distancë prej 4.5 hapash. Ktheva dorën për të bërë vetëvrasje, por disa policë dhe oficerë më kapën. Ata më morën me vete, për në stacionin e policisë. Unë nuk jam kriminel, por hoqa qafe një njeri të keq. Unë mendova se kjo ishte një gjë e drejtë”

Gavrilo Princip

Kjo vrasje shërbeu si shkëndijë për fillimin e një prej ngjarjeve më të rëndësishme të shek. XX. Identifikoni ngjarjen dhe evidentoni dy nga shkaqet e fillimit të saj.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 8:

Plot 100 vite e ndajnë Revolucionin e Lavdishëm nga Revolucionin Francez, me një kontekst shumë të ndryshëm gjeografik dhe historik mes tyre. Për pasojë, ata paraqesin aspekte të ndryshme mes njeri-tjetrit, megjithëse secili mund të konsiderohet si një revoltë ndaj mbizotërimit të monarkisë absolute.

Vlerësoni ndryshimet mes rrjedhøjave politike te Revolucionit të Lavdishëm në Britani dhe Revolucionit Francez.

Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 9:

Lufta II Botërore filloi në 1 Shtator 1939, por fara e saj ishte mbjellë vite më parë. Gjermania ishte shteti iniciues i këtij konflikti, të konceptuar nga ekstremizmi dhe agresiviteti territorial, etnik, ideologjik i Partisë Nacional-Socialiste (Naziste) dhe udhëheqësit të saj Adolf Hitler.

Triumfi politik, që çoi në marrjen e pushtetit dhe arritjen e një konsensusi të rëndësishëm nga ana e popullsisë për politikën e nazistëve, nuk ishte një fenomen i rastit por,

në një masë të madhe, rrjedhøjë e rrethanave ekonomiko-shoqërore dhe politike, të krijuara në Gjermani, në periudhën mes dy luftërave botërore.

Analizoni ndikimin e qëndrimit të Fuqive fituese të Luftës I Botërore, shprehur në Traktatin e Paqes së Versajës (28 Qershor 1919) dhe i politikës së tyre ndaj Gjermanisë së mundur. Ilustroni opinionin tuaj, bazuar edhe te figura e dhënë.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Analiza shkak-pasojë, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.



Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 10:

Reformacioni protestant ishte një lëvizje politike apo fetare. Argumentoni mendimin tuaj nëpërmjet fakteve dhe shembujve konkretë.

Kompetenca: Kërkimi historik, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 11:

Një nga figurat më të njohura të iluminizmit evropian dhe jo vetëm, vendosi theksin tek misioni që ka çdo qeveri në mbrojtjen e lirive e të drejtave të qytetarëve. Nëse ajo nuk e realizon këtë mision dhe e shpall veten mbi ligjin, populli ka të drejtë ta rrëzojë atë". Argumentoni shprehjen e iluministit Xh. Lok: "Qeveria duhet t'i shërbejë shoqërisë".

A janë qeveritë që i shërbejnë shoqërisë apo shoqëria i shërben qeverisë? Jepni shembuj nga historia botërore.

Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 12:

Argumentoni përse paqja e vendosur në Konferencën e Versajës në vitin 1919 u quajt si “paqe e gabuar dhe ndëshkuese”.

Kompetenca: Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

KLASA XI

Pyetja 1:

Hartimi i Kodit Penal, Civil dhe Tregtar me standarde evropiane u bë gjatë viteve të:

- A) Qeverisë së Sulejman Delvinës (1920);
- B) Qeverisë së Fan Nolit (1924);
- C) Republikës Shqiptare (1925-1928);
- D) Monarkisë Shqiptare (1928-1939).

Kompetenca: Kërkimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Për pohimet e mëposhtme zgjidhni V nëse pohimi është i vërtetë dhe G nëse është i gabuar.

- a) Vendosja e regjimit monarkik pas lufte dhe rikthimi i mbretit Zogu I, ishte pjesë përbërëse e programit politik të Ballit Kombëtar.
V/G_____
- b) Ndalimi me ligj i fesë në Shqipëri, u vendos në kushtetutën e vitit 1976. V/G_____
- c) Shkëputja e marrëdhënieve diplomatike/ekonomike të Shqipërisë me shtetet e tjera në rend kronologjik është si vijon: Jugosllavi - Bashkim Sovjetik – Kinë. V/G_____

Kompetenca: Interpretimi historik dhe organizimi kronologjik

Lloji i pyetjes: Pyetje e vërtetë e gabuar

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 3:

“Ahmet Zogu qe kthyer në pushtet me ndihmën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, kryesisht sepse ajo shpresonte të kënaqeshin pretendimet e saj territoriale. A. Zogu ishte i vendosur t’i jepte fund vështirësive ekonomike, që cikloheshin në mënyrë të pandërprerë. Në këto rrethana, kursi i tij ishte të kthehej nga Italia dhe njëkohësisht ta zbuste Jugosllavinë duke i njohur pretendimet e saj”.

Joseph Suire, “Ngritja e një Mbretërie”

- a) Identifikoni ndryshimin territorial që ndodhi mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut.
- b) Shpjegoni dy nga arsyet pse marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene nuk patën jetëgjatësi.

Kompetenca: Analiza shkak – pasojë, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar (e strukturuar)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Në gusht 1943 në takimin e mbajtur në Mukje morën pjesë përfaqësues të Frontit Nacional Çlirimtar dhe të Ballit Kombëtar.

- a) Evidentoni një nga vendimet e marra me miratimin e përfaqësuesve të dy palëve në këtë takim.
- b) Shpjegoni dy arsye pse PKSH i hodhi poshtë pikat e kësaj marrëveshjeje.

Kompetenca: Interpretimi historik

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të kufizuar (e strukturuar)

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 5:

Në kolonën e majtë jepen kongreset e mbajtura në Shqipëri, ndërsa në kolonën e djathtë vendimet që janë marrë në këto kongrese. Lidhni me shigjetë kongresin me vendimin përkatës.

Kongresi i Elbasanit	Krijimi i qeverisë më në krye Sulejman Delvinën
Kongresi i Manastirit	Ndalimi i rikthimit të ish-mbretit Zog në Shqipëri
Kongresi i Përmetit	Caktimi i alfabetit shqip
Kongresi i Lushnjës	Ngritja e shkollës normale për përgatitjen e mësuesve

Kompetenca: Analiza shkak – pasojë

Lloji i pyetjes: Pyetje me kombinim (me çiftëzim)

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Asambleja Kushtetuese likuidoi Ministrinë e Jashtme dhe forcat e armatosura shqiptare u shkrinë me ato italiane. Këto fakte tregojnë:

- A) Humbjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe kthimin e saj në një provincë italiane.
- B) Ndryshimin e formës së regjimit në Shqipëri nga republikë në monarki.
- C) Arritjen e balancimit të pushteteve në Republikën Shqiptare.
- D) Shkëputjen e Shqipërisë nga ndikimi ekonomik italian.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Analiza shkak-pasojë.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 7:

Kryeqendra e principatës së Arbrit ishte _____.

Konceptet: Kuptimi kronologjik, Ndryshimi dhe vazhdimësia

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të shkurtër (me plotësim)

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 8:

Referojuni dy dokumenteve të mëposhtëm për t'ju përgjigjur pyetjes.

Dokumenti nr. 1 Pjesë nga “Kushtetuta e vitit 1946”

Neni 5: ... Tregtia e jashtme është nën kontrollin e shtetit.

Neni 9: Garantohen pronësia private dhe iniciativa private në ekonomi. Garantohet e drejta e trashëgimit të pasurisë private.

Neni 10: Toka u takon atyre që e punojnë. Caktohet me ligj kur një institut ose një person që nuk e punon tokën mund të mbetet zot i kësaj toke dhe në ç' masë. Tokat e mëdha për asnjë arsye nuk mund të jenë në duart e privatëve.

Neni 16. Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdoren për qëllime politike. Gjithashtu ndalohen organizatat politike me bazë fetare. Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare.

Neni 18. Të gjithë shtetasve u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik.

Neni 19. Toka u jepet në përdorim shoqëror ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore, kooperativat bujqësore dhe organizatave shoqërore, si dhe në përdorim vetjak shtetasve. Toka jepet në përdorim pa shpërblim. Toka bujqësore mund të përdoret për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin e organeve shtetërore përkatëse.

Dokumenti nr. 2 Pjesë nga “Kushtetuta e vitit 1976”

Neni 16: Ekonomia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është ekonomi socialiste, që mbështetet në pronën socialiste mbi mjetet e prodhimit. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka klasa shfrytëzuese, janë zhdukur dhe ndalohen prona private e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut.

Neni 27: Tregtia e jashtme është monopol i shtetit. Tregtia e brendshme ushtrohet kryesisht nga shteti, i cili ka nën kontroll çdo veprimtari në këtë fushë. Çmimet e shitjes së produkteve të ndërmarrjeve si edhe çmimet e blerjes së produkteve bujqësore e blegtorale nga shteti caktohen prej tij.

Neni 28: Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë ndalohet dhënia e koncesioneve, krijimi i shoqërive dhe institucioneve të tjera ekonomike e financiare e të huaja ose të përbashkëta me monopolet dhe me shtetet kapitaliste, borgjeze e revizioniste, si edhe marrja e kredive prej tyre.”

Neni 37: Shteti nuk njuh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.

- a) Bazuar te dokumentet e mësipërme krahasoni Shqipërinë e vitit 1946 me atë të vitit 1976 në planin politik dhe ekonomik – shoqëror dhe nxirrni të paktën tri përfundime.
- b) A e përmirësoi ekonominë e Shqipërisë miratimi i kësaj kushtetute? Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Analiza shkak-pasojë, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Lloji i pyetjes:

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 9:

Midis viteve 1945 dhe 1950, aleanca e kohës së luftës midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik u ndërpre dhe filloi Lufta e Ftohtë. Për 40 vitet e ardhshme, marrëdhëniet midis dy superfuqive u lëkundën midis konfrontimit dhe detantës. Secili u përpoq të rriste ndikimin e vet mbarëbotëror dhe të përhapte sistemet e veta konkurruese ekonomike dhe politike. Kjo dinamikë përcaktoi, në një masë të madhe, edhe pozicionin politiko-diplomatik të Shqipërisë.

Analizoni ndikimin e Luftës së Ftohtë në pozitën ndërkombëtare dhe politikën e jashtme të Shqipërisë në vitet 1945-1990.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Analiza shkak-pasojë.

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 10:

“Pas marrjes së pushtetit, dishepujt e Karl Marksit njihnin vetëm dy klasa: “Proletariatit e zhveshur nga prona, të përbërë prej punëtorëve të industrisë dhe fshatarëve të bujqësisë, si dhe antitezën e tij, klasën shfrytëzuese kapitaliste (dyqanxhinj, pronarë tokash, profesionistë, kleri etj.) të quajtur “borgjezi”. Për ta zhdukur këtë dallim klasor ideatorët marksistë, shtetëzuan industrinë, minierat, bankat, tregtinë e transportin, ndërsa pronarët e tokave do të shpronësoheshin me anën e Reformës Agrare e cila do të vendoste pronësinë dhe administrimin e tokës në duart e shtetit. Duke vënë arsimin, mjekësinë, ligjin nën kontrollin e shtetit, do të zhvisheshin nga pushteti profesionistët. Autoriteti i klerit do të shkatërrohej duke shtënë në dorë të gjitha institucionet dhe pronat e fesë, kurse vetë kleri do të degdisesh në kampe pune, burgje, punëtor krahu në industri e bujqësi. Në këtë mënyrë teorikisht do të zhdukej plaga e vjetër e pabarazisë.”

A mendoni se masat e mësipërme të marra edhe nga regjimi komunist në Shqipëri, vendosën realisht barazinë shoqërore? A sollën këto përpjekje më shumë mirëqenie dhe i dhanë një tjetër fytyrë shoqërisë sonë? Argumentoni mendimin tuaj nëpërmjet shembujve konkretë.

Kompetenca: Përdorimi i burimit, Analiza shkak-pasojë, Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Lloji i pyetjes: Pyetje subjektive me përgjigje të hapur

Pikëzimi: 4 pikë

Skema e vlerësimit për pyetjet me fund të hapur

4 pikë	3 pikë	2 pikë	1 pikë	0 pikë
<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi tregon një të kuptuar të qartë/plotë të temës/problema tikës. - Zhvillon të gjitha aspektet e temës/problema tikës, madje edhe në thellësi, - Është më shumë analizuese sesa përshkruese, - Mbështetet në shumë fakte konkrete, shembuj specifikë dhe detaje, - Demonstron një organizim logjik të argumentimit të temës. 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon përceptazi të gjitha aspektet e temës/problema tikës, - Është më shumë përshkruese se analizuese - Përfshin disa fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla - Demonstron një organizim të kënaqshëm të argumentimit të temës 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon minimalisht aspektet e temës/problem atikës - Është më shumë përshkruese, përfshin pak fakte, shembuj; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla - Përfshin pak fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla - Demonstron një organizim të paqartë të temës. 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon aspektet minimale të temës/problema tikës; - Nuk përmban analizë; - Përfshin disa fakte konkrete, shembuj dhe detaje; mund të përfshijë edhe disa pasaktësi të vogla - Demonstron një organizim të paqartë, nuk ka një lidhje logjike midis paragrafëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Dështon në argumenti min e temës - OSE nuk përfshin fakte OSE - është e pakuptues hme OSE - nuk shkruan asnjë fjalë.
<p><i>Për pyetjet me fund të hapur pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.</i></p>				



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

